



QENDRESA  
QYTETARE

FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG



2020

5 VJET NGA  
**REFORMA  
NË ARSIMIN  
E LARTË**



Qëndresa Qytetare, me mbështetjen e Fondacionit gjerman Friedrich Ebert, kërkon të nxisë debatin publik mbi arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, me qëllim miratimin e politikave të ndërlidhura me realitetin dhe që synojnë përmirësime pozitive në një fushë me ndikim të thellë në jetën në vend, siç është ajo e arsimit dhe kërkimit shkencor.

Punuar nga:

**Prof. Dr Eralda (Methasani) Çani**

**Prof. Asoc.Dr Enkeleda Olldashi**

Ky botim u realizua nga Qëndresa Qytetare me mbështetjen financiare të Fondacionit Friedrich Ebert. Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkrijnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Tiranë 2020

## Përmbajtja

Shkurtesa.....	4
1. Hyrje .....	5
2. Metodologjia.....	10
2.1. Qasja kërkimore .....	10
2.2. Mbledhja e të dhënave .....	10
2.3. Etika në kërkim .....	11
2.4. Target grupi .....	11
3. Akses i studentëve në arsimin e lartë.....	12
4. Shërbimet studentore dhe administrimi financiar në IAL-të publike .....	14
5. Liria dhe promovimi akademik .....	16
6. Etika dhe integriteti akademik .....	18
7. Akreditimi i programeve të studimit .....	20
8. Të drejtat e studentëve në universitete .....	22
8.1 Pesha e votës dhe përfaqësimi i studentëve në zgjedhjet në universitete dhe Bordet e Administrimit .....	22
8.2 Sistemi i vlerësimit pedagog – student dhe anasjellas .....	24
9. Ligji 80/2015, nevojë për përmirësim apo ndryshim .....	25
10. Gjetjet kryesore.....	29
11. Rekomandime .....	30
Aneks 1 .....	31
Aneks 2.....	35
Aneks 3.....	38



## Shkurtesa

ASCAL	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
AKFAL	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë
BE	Bashkimi Evropian
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
Ligj 80/2015	Ligj nr.80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
SKS	Sondazhi Kombëtar të Studentëve
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
AI	Arsim i Lartë
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
IT	Teknologjia e Informacionit



## 1. Hyrje

Arsimi i lartë dhe reforma arsimore universitare ka qenë dhe mbeten një nga temat më të rëndësishme publike në vend. Kjo reformë është adresuar në një sërë tryezash dhe debatesh publike përgjatë viteve, të cilave iu shtuan dhe protestat studentore të muajit dhjetor 2018.

Edhe pse të gjitha ligjet e miratuara pas vitit 1990 për arsimin e lartë<sup>1</sup> kanë synuar reformimin e sistemit universitar përmes standardeve akademike, rritjes së cilësisë, transparencës, autonomisë universitare dhe rezultateve të kërkimit shkencor, përvoja 20 vjeçare tregon se ky reformim ka qenë i përkohshëm dhe jo efektiv. Kuadri ligjor në këtë fushë ende nuk ka nxitur në masën e duhur reformimin e brendshëm të jetës universitare.<sup>2</sup>

Hapat më rëndësishme të reformimit të sistemit universitar shënohen në vitet 1999-2007<sup>3</sup>, kohë në të cilën institucionet e arsimit të lartë përshtatën kurrikulat e tyre me standardet e Procesit të Bolonjës. Kjo periudhë përkon edhe me hapjen e institucioneve të para jopublike të arsimit të lartë.<sup>4</sup>

Një argument ndikues pro reformës së thellë, ishte vetë gjendja alarmante ku ndodhej sistemi arsimor, rënia e prestigjit publik, një numër skandalesh publike dhe masiviteti jashtë kriterëve më normale i pjesëmarrjes së grupmoshave të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë, sidomos në sektorin privat. Gjatë viteve 2009-2013, sidomos në prag të proceseve elektorale, sistemi universitar u liberalizua në atë formë dhe mënyrë sa dukshëm përshfaqti elementë deformues

<sup>1</sup> Ligji i parë pas rëzimit të komunizmit në vend, u miratua nga mazhoranca e djathtë në 1994 (Ligj nr. 7810, datë 4.1.1994," Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë". botuar në Fletore Zyrtare nr. 5, Maj 1994); ligji i dytë u miratua nga mazhoranca e majtë në 1999 (Ligj nr. 8461, datë 25.2.1999," Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", botuar në Fletore Zyrtare nr. 9, datë 16.03.1999. Shih në: <http://qzbz.gov.al/eli/ligj/1999/02/25/8461>); ligji i tretë u miratua nga mazhoranca e djathtë në 2007 (Ligj nr. 9741, datë 21.5.2007," Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", botuar në Fletore Zyrtare nr. 68, datë 16.06.2007. Shih në: <https://qzbz.gov.al/eli/ligj/2007/05/21/9741>) dhe ligji i katërt që është në fuqi, u miratua nga mazhoranca e majtë në vitin 2015 (LIGJ Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", botuar në Fletore Zyrtare nr. 9, datë 16.03.1999. Shih në: <https://qzbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80>).

<sup>2</sup> Papanisto A., *Zhvillimi i Qëndrueshëm dhe Ligji 80/2015 i Arsimit të Lartë për Kërkimin Shkencor në IAL*, në 'Projeksione për një zhvillim të qëndrueshëm', Revista 1, shkurt 2018, Rrjeti Shqiptar i Grave në Shkencë Qendra rajonale për zhvillim të qëndrueshëm, fq. 21-28. Shih në: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/14222/revista-2018-1.pdf>

<sup>33</sup> Në vitin 2001, nënshkruhet Marrëveshja e Lisbonës për njohjen e diplomave dhe fillimin e sistemit të njohjes së diplomave të huaja në vend sipas kriterëve dhe standardeve evropiane, të parashikuara në kuadrin e Procesit të Bolonjës; fillon zbatimi i sistemit ECTS (European Credits Transfer Sistem) në të gjitha kurrikulat e IALve në Shqipëri. Në vitin 2003, hyjmë zyrtarisht në Procesin e Bolonjës. Shih në: <http://www.ehea.info/page-albania>

<sup>4</sup> Në vitin 2002, u licencuan institucionet e para private dhe deri në vitin 2005 funksiononin vetëm 5 IAL private, pothuajse të gjitha të specializuara (Nju Jork, Marubi, Luarasi, Zoja e Këshillit të Mirë dhe Fakulteti i Stomatologjisë i UFO-s). Shih: Komisioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, Raporti përfundimtar për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Tiranë, Korrik 2014, në [https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf)

nga koncepti i dijes, arsimit dhe shkencës. Një numër shkollash të larta, kolegësh, universitetesh, filialesh të tyre, etj, vepruan me shtrirje në të gjithë vendin, duke i dhënë prioritet fitimeve financiare dhe ndikuar në jetësimin e një politike të edukimit masiv në arsimin e lartë pa një analizë të mirëfilltë tregu, në dëm të cilësisë, konkurrencës profesionale dhe standardit të dijeve.

**Ligj nr.80/2015, datë 22.7.2015**, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" u prezantua në ambjentet universitare dhe më gjerë si një domosdoshmëri për reformimin e thellë të sistemit universitar. Momenti lidhej me rënien e prestigjitet publik të universiteteve, skandalet publike dhe masivitetin jashtë kriterëve të hyrjes në institucionet e arsimit të lartë privat.<sup>5</sup>

**Ligji synonte** krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm të brendshëm dhe të jashtëm të kontrollit akademik dhe financiar, duke synuar njësimin dhe standardizimin e sistemit arsimor në vend me atë europian.<sup>6</sup> Arsimi i lartë të konsiderohej një shërbim publik dhe e mirë publike, pavarësisht nga forma e pronësisë.<sup>7</sup> Ligji synonte dhe ritjen e cilësisë dhe shërbimeve që universitetet publike duhet të ofrojnë për studentët, nxitjen e autonomisë financiare, e cila duhej të diversifikohej përmes mënyrave të financimit të IAL-ve, autonomisë në administrimin e të ardhurave, si dhe një autonomie të kontrolluar në vendosjen e tarifave të studimit, brenda një tarife tavan. Një ndër synimet kryesore të ligjit ka qenë edhe autonomia akademike, duke garantuar që IAL-të gëzonin të drejtën për të vendosur vetë për kurrikulat, fushat e kërkimit, metodat e mësimdhënies, si dhe për programet e mësimdhënies.<sup>8</sup>

Ligji 80/2015 miratoi një kuadër të ri politik për arsimin e lartë në vitin 2015. Tashmë kanë kaluar pesë vjet nga zbatimi i kësaj reforme të sistemit të arsimit universitar. Miratimi dhe zbatimi i kësaj reforme është shoqëruar me debate të ashpra mes qeverisë dhe stafëve akademike, reagime të mëdha studentore, ndër të cilat edhe protesta e dhjetorit 2018. Gjatë kësaj kohe studentët kanë perceptuar edhe rënie të cilësisë së arsimit.<sup>9</sup> Ky ligj u shoqërua, që gjatë hartimit të tij, me një sërë debatesh mbi nevojën e hartimit të tij. Disa prej rregullimeve të tij morën vëmendje të veçantë, si p.sh. politika e mbështetjes financiare për IAL-të.

Ndërsa rezultatet që vijnë prej qasjeve empirike janë të diskutueshme, një qasje shkencore ndihmon më shumë qëndrimet e arsyeshme ndaj aspekteve rregullatore të organizimit dhe funksionimit të arsimit të lartë në vend. Në këtë

<sup>5</sup> Afrim Krasniqi, Reforma në Arsimin e Lartë 2015-2018: Risitë dhe Problematikat, Qeshor 2018. Shih në: [https://www.researchgate.net/publication/326305365\\_REFORMA\\_NE\\_ARSIMIN\\_E\\_LARTE\\_2015-2018\\_RISITE\\_DHE\\_PROBLEMATIKAT](https://www.researchgate.net/publication/326305365_REFORMA_NE_ARSIMIN_E_LARTE_2015-2018_RISITE_DHE_PROBLEMATIKAT)

<sup>6</sup> Raporti Përfundimtar "Për reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor" (pika 2.1.6), Komisioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, korrik 2014.

<sup>7</sup> Sipas pikës 2.1.1, të Raporti Përfundimtar "Për reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimin Shkencor".

<sup>8</sup> Relacion për projektligjin "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Shih në:

[http://parlament.al/Files/ProjektLigje/relacion\\_arsimi\\_i\\_larte\\_21943\\_1.pdf](http://parlament.al/Files/ProjektLigje/relacion_arsimi_i_larte_21943_1.pdf) (aksesuar në korrik 2020)

<sup>9</sup> Çela a. & Kamberi G., Studimi Rinia Shqiptare 2018 /2019. Shih në <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15257.pdf> (aksesuar në korrik 2020).



këndvështrim, Qëndresa Qytetare ka realizuar disa studime që lidhen me aspekte të ndryshme të jetës universitare dhe zbatimit të politikave.<sup>10</sup>

Qëndresa Qytetare, në tre vite monitorim të proceseve arsimore, përmes analizave të realizuara ka vënë në pah një sërë problematikash që lidhen me:

- Mungesën e nxjerrjes dhe zbatimit të akteve nënligjore të ligjit 80/2015;
- Problematikat e artikuluar në Protestën Studentore, Dhjetor 2018 (8 pikat);
- Keq - administrimin financiar të universiteteve publike;
- Nivelin e korrupsionit pedagog – student, në rritje nga 2015;
- Përplasjet Bord Administrimi – Senat Akademik;
- Shpopullimin e Universiteteve publike në rrethe;
- Mungesën e infrastrukturës dhe mjeteve mësimore;
- Shërbimet e munguara studentore përballë tarifave më të larta në Rajon, për ciklin e dytë të studimeve,
- Mungesën e të drejtave dhe përfaqësimit të studentëve në vendimmarrjen e universitetit (10 % pesha e votës).<sup>11</sup>

Ky vlerësim është në vazhden e analizave që Qëndresa Qytetare ka ndërmarrë. Duhet thënë se *studimi nuk është qëllim në vetvete, por i shërben njohjes së jetës universitare dhe kërkimore shkencore në vendin tonë, me qëllim zhvillimin dhe zbatimin e politikave.*

Nevoja për vëmendje ndaj arsimit të lartë është e lidhur ngushtë me zhvillimin e shoqërisë, sepse **arsimi i lartë është hallka kyçe e ushqimit të tregut me burimet e nevojshme njerëzore për funksionim apo edhe një ndër hallkat kyçe për realizimin e analizave dhe studimeve të nevojshme për mirëfunksionimin e tregut.** Gjithashtu, kjo është e lidhur ngushtë me realizimin e politikave të brendshme dhe të jashtme në fushën e arsimit dhe kërkimit shkencor. Programi politik i qeverisë 2017-2021 përfshin ndër qëllimet politike të vetat edhe ato të lidhura me arsimin e lartë, i cili kërkohet të jetë cilësor dhe i orientuar nga tregu i punës. Ky program ka në vëmendje kërkimin shkencor dhe financimin e tij, me qëllim që universitetet të mbështeten si qendra të zhvillimit ekonomik e social të vendit, duke i konsideruar ato si një e mirë publike dhe themele të ndërtimit të së ardhmes.<sup>12</sup> Prania e universiteteve shqiptare publike dhe private në programet europiane të kërkimit shkencor synon të rritet. Rëndësia e një kuadri rregullator të plotësuar është vënë në vëmendje në këtë program me qëllim përmbylljen e saj dhe vënien në funksion të mekanizmave të reformës në arsimin e lartë. Analiza e ndërmarrë ndihmon një kuptim më të mirë të realizimit të reformës në arsimin e lartë në vend.

<sup>10</sup> <https://qq.com.al/>

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> Programi qeverisës 2017-2021, fq. 19, thekson:

. . . arsimi dhe kërkimi shkencor janë një e mirë publike, themelet e ndërtimit të së ardhmes, rruga kryesore e progresit dhe e përballimit të sfidave të integritetit euroatlantik. Busulla jonë mbetet arsimi cilësor sipas standardeve më të mira të Bashkimit Europian.

Shih në: <https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf> (aksesuar në korrik 2020).

Edukimi, përfshirë këtu edhe atë të lartë, është përfshirë në Objektivin 4 të Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili synon 'një edukim përfshirës dhe njësoj cilësor dhe promovimin e mundësive gjatë gjithë jetës për të gjithë'.<sup>13</sup> Çdo analizë, perceptim apo vëzhgim i situatës ndihmon drejtpërdrejt në kuptimin e nivelit të realizimit të një qëllimi të tillë. Gjithashtu, fushat e arsimit dhe kërkimit janë dy fusha të veprimtarisë në të cilën vendi ynë kërkohet të përparojë edhe me qëllim realizimin e kërkesave të procesit të integritetit evropian. Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, thekson se Shqipëria është në një fazë të hershme në fushën e shkencës dhe kërkimit. Në këtë raport vlerësohet se është bërë disi progres në fushën e shkencës dhe kërkimit, ndërsa ka një përgatitje të moderuar dhe është bërë disi progres në fushën e arsimit.<sup>14</sup> Në një krahasim tjetër me qasjet e BE-së, mund të thuhet që vendi ka ende për të bërë për sa i përket mbështetjes buxhetore të arsimit dhe shkencës. Ndërsa në BE-27 gjatë vitit 2018, shpenzimet e qeverisë për arsimin zinin mesatarisht 4.6% të PBB,<sup>15</sup> në Republikën e Shqipërisë shpenzimet për arsimin ishin 3.1% të PBBsë për vitin 2017, duke u renditur e fundit në Rajon për shpenzimet dedikuar arsimit, dhe në nivelin 2.469% të PBB-së për vitin 2018<sup>16</sup>. Programi i qeverisjes 2013-2017 parashikonte rritjen e financimit të arsimit në 5%<sup>17</sup> të PBBsë, premtim që nuk u realizua, ndërsa Programi i qeverisjes 2017-2021 nuk përfshin më një shifër për mbështetjen e sektorit të arsimit.<sup>18</sup>

Në këtë kontekst realizohet ky studim, i cili, nisur nga nevoja për të gjeneruar ide/sugjerime dhe rekomandime nga akademikë dhe ekspertë për përmirësimin e legjislacionit mbi arsimin e lartë, fokusohet në disa nga çështjet e lidhura me arsimin e lartë. Këto përfshijnë: pranimin në IAL, aspekte të ndërthurura me jetën akademike dhe studentore si liria akademike apo integriteti akademik, krijimin e institucioneve dhe organeve drejtuese në IAL, si dhe disa aspekte të lidhura me to, si meritokracia e krijimit të organeve, pesha e votës së studentëve në zgjedhjet akademike, apo edhe administrimin financiar të universitetit. Studimi përqëndrohet në këto çështje, por synon të ofrojë edhe disa rekomandime lidhur me qasjen e politikës në fushën e arsimit të lartë në vend.

<sup>13</sup> Shih Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm të miratura nga Kombet e Bashkuara në: <https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/sustainable-development-goals/goal-4-quality-education.html> (aksesuar në korrik 2020).

<sup>14</sup> Vlerësimi për Kapitujt 25-27, në fq. 99-102. Shih në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf> (aksesuar në 20.04.2020).

<sup>15</sup> EUROSTAT, shih në:

[https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Government\\_expenditure\\_on\\_education#:~:text=-,Table%201%3A%20Total&text=In%202018%2C%20general%20government%20expenditure,accounted%20for%201.7%20%25%20of%20GDP](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Government_expenditure_on_education#:~:text=-,Table%201%3A%20Total&text=In%202018%2C%20general%20government%20expenditure,accounted%20for%201.7%20%25%20of%20GDP).

<sup>16</sup> INSTAT nuk paraqet të dhëna të ndara për arsimin apo vetëm për arsimin e lartë. Shih të dhënat në: <https://data.worldbank.org/indicator/SE.XPD.TOTL.GD.ZS?locations=AL>

<sup>17</sup> Programi i qeverisjes 2013-2017, parashikon shprehimisht se:

.. Synimi është që financimi publik për arsimin të arrijë në nivelin e 5% e PBB me qëllim që të sigurohet arsim cilësor për çdo fëmijë, pavarësisht origjinës, rrethanave familjare, apo gjendjes ekonomike. ..

Shih fq. 47, në [https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Programi\\_Qeverise.pdf](https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Programi_Qeverise.pdf) (aksesuar në korrik 2020)

<sup>18</sup> Shih në: <https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf> (aksesuar në korrik 2020).



Qëndresa Qytetare falenderon të gjithë ekspertët dhe pedagogët që bashkëpunuan e kontribuan në kuadër të këtij studimi, veçanërisht:

*Prof. Dr Anila Papparisto, Prof. Dr Mimoza Hafizi, Prof. Dr Anila Neziri, Prof. Asoc.Dr Afrim Krasniqi, Prof. Asoc.Dr Arben Bushgjokaj, Prof. Asoc.Dr Edmont Laho, Prof. Asoc.Dr Regjina Gokaj, Prof. Asoc.Dr Gentiana Kera, Dr. Blendi Ceka, Dr. Merita Poni, Dr. Rinald Muça, Dr Peter Saraçi, Dr. Edlira Gjoni, Dr. Blerina Hamzallari, Dr. Luan Myrtaj, Dr. Mirjam Rec,*

dhe studentët e përfshirë:

Sidorela Vatnikaj, Teisa Kurti, Anila Salianji, Fatjon Biba, Suada Dida, Dragana Kurti, Juliana Dema, Tea Zeqaj, Jona Voci, Erjola Ramazani, Orgesa Zaimi, Arestina Skenderi, Diana Mjeshtri, Donada Rata, Ana Gjoka.



## 2. Metodologjia

Ndërhyrja që propozohet përmes këtij studimi është analizë studimore e problematikave dhe propozim i zgjidhjeve konkrete nëpërmjet ndryshimeve ligjore apo një kuadri të ri legjislativ për Universitetin.

### 2.1. Qasja kërkimore

Qasja kërkimore ishte ajo induktive, sipas së cilës u fillua me vëzhgime të posaçme, të cilat ndihmuan të arrihen disa konkluzione. Këto të fundit ishin bazë për rekomandimet e përfshira në studim. Puna kërkimore u mbështet në vlerësime me karakter shkencor dhe jo thjesht empirik. Qasja kërkimore mban në konsideratë kontekstin mbi të cilin u realizua kërkimi: në vendin tonë janë 41 IAL në total, nga të cilat 15 IAL publike dhe 26 private aktive, ndërsa 26 janë mbyllur.<sup>19</sup> Studimi synon të përfshijë sa më gjerë IAL-të publike në vend, me qëllim pasjen e një shtrirje gjithëpërfshirëse të analizës.

Për realizimin e këtij studimi bashkëpunuan 20 veta, nga të cilët 8 me tituj akademikë dhe 12 me grada shkencore; nga IAL-të publike të Tiranës, Durrësit, Shkodrës dhe Elbasanit. Gjithashtu, bashkëpunuan 15 studentë, nga të cilët 10 të ciklit të parë dhe 5 të ciklit të dytë dhe të tretë, nga IAL-të publike të Tiranës, Durrësit, Shkodrës e Elbasanit. Nga bashkëpunëtorët, 18 ishin vajza e gra dhe 17 burra e djem.

### 2.2. Mbledhja e të dhënave

Për qëllimet e këtij studimi, u përdoren këto metoda të mbledhjes së të dhënave:

- a-** Kërkim literature: me qëllim identifikimin e analizave shkencore të realizuara për zbatimin e ligjit 80/2015 dhe ndikimin e tij në universitete si dhe vlerësimeve rajonale dhe më gjerë me qëllim reflektimin e një qasje analitike krahasimore gjithashtu;
- b-** 10 Intervista gjysëm të strukturuar: Intervistat shërbyen për të mbledhur qasjet e ekspertëve të njohur dhe drejtpërdrejtë të përfshirë në fushën e arsimit të lartë në vend, lidhur me çështjet kryesore që trajtohen në këtë studim (Shih Aneks 1 për pyetësin e përdorur);
- c-** Realizimi i dy bisedave në grupe (Shih Aneks 2 dhe 3 për pyetësin e përdorur):
  - 1 (një) me 10 pedagogë të përfshirë në jetën publike dhe debatin për universitetin, dhe
  - 1 (një) me 15 studentë aktivë dhe përfaqësues në Këshillat Studentore, të përfshirë në jetën publike dhe debatin për universitetin.

<sup>19</sup> [https://www.asc.al/sq/?option=com\\_k2&vie=item&layout=item&id=6&Itemid=677](https://www.asc.al/sq/?option=com_k2&vie=item&layout=item&id=6&Itemid=677)

Citimet e të intervistuarve janë në funksion të qëllimit të këtij studimi dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera. Idetë dhe mendimet e realizuara gjatë bashkëbisedimit me bisedat në grup me pedagogët janë pjesë të analizës së këtij studimi. Nga opinionet e dhëna në intervistat e realizuara janë shkëputur ato citime të janë gjykuar në funksion të këtij studimi. Pyetësorët e realizuar kanë synuar të përfshijnë një sërë çështjesh të cilat jo të gjitha janë përfshirë në këtë studim, për shkak të kufizimeve në dhënien e mendimeve apo reflektimeve nga pjesëmarrësit në të.

### 2.3. Etika në kërkim

Për shkak të situatës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shpalluar me Akt Normativ nga qeveria dhe miratuar nga Kuvendi, si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga CODIV-19, të gjitha intervistat dhe fokus-grupet, u realizuan përmes komunikimit elektronik, përmes adresave të postave elektronike, si dhe duke përdorur formatet e hapura Google Forms, si dhe komunikimit verbal përmes formatit 'Zoom meeting' dhe 'Google Meet'. Qëndresa Qytetare respektoi politikën e privatësisë dhe detyrimet e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke kërkuar pëlqimin të intervistuarve për regjistrimin e komunikimeve me to.

### 2.4. Target grupi

Target grup kryesor i këtij studimi janë strukturat e pedagogëve dhe studentëve të universitetet publike në vend. Gjithashtu, një target grup tjetër janë edhe politikëbërësit të ngarkuar nga Kushtetuta me hartimin e politikave në vend, përfshirë këtu Kuvendin<sup>20</sup> si dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin, MASR,<sup>21</sup> si hartuesit kyç të politikave të arsimit të lartë në vend, përkatësisht hartues dhe miratues të ligjit për arsimin e lartë. Gjetjet kryesore të studimit do t'i ndahen Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit, si dhe MASR.

<sup>20</sup> Pjesa 3, kreu 4 Kushtetuta dhe Neni 100 dhe 102 Kushtetuta:  
<https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/kushtetuta.pdf>

<sup>21</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave 505, datë 13.9.2017.FZ 166 / 2017.



### 3. Aksesit të studentëve në arsimin e lartë

Me ndryshimin e ligjit për arsimin e lartë në vitin 2015, ndryshoi edhe mënyra e aksesit të studentëve në universitete. Kjo solli një seri problematikash. Së pari koha në të cilën u zbatuan rregullat e reja ishte e papërshtatshme; rregullat ndryshuan dy muaj para procesit të pranimeve, ndërkohë që aspektet procedurale të zbatimit të ligjit nuk ishin qartësuar ende. Këto ndryshime, me kalimin e kohës u neutralizuan disi nga MASR nëpërmjet nxjerrjes së akteve nënligjore.

Ndryshimi i shpeshtë i filozofisë së sistemit, nga ai Finlandez tek sistemi Gjerman dhe më pas tek ai Anglo-Sakson, pa patur më parë një studim paraprak dhe pa kontaksualizuar këto ndryshime me realitetin e vendit tonë, ka krijuar një klimë jo favorizuese për procesin e pranimeve në IAL. Ndryshimet e shpeshta të kriterëve të pranimit gjatë rrugës së formimit të tyre nuk i ndihmojnë maturantët që të përputhin ritmet e studimeve të tyre me këto kriterë.

Nga ana tjetër, në aspektin strategjik, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk adreson në mënyrë të decentralizuar procesin e pranimeve në IAL-të publike, si për ciklin e ciklin e parë të studimeve, ashtu edhe për të dytin, edhe pse Ligji 80/2015, në nene të ndryshme të tij i ka njohur një sërë kompetencash universiteteve për mbarëvajtjen e procesit pranues të studentëve.<sup>22</sup>



Ekspertët dhe studiuesit në fushën e arsimit të lartë bien dakord se kriteret e pranimit, kuotat dhe mesatarja në kuadër të autonomisë akademike, duhet të vendosen dhe të aplikohen nga vetë universitetet, **pasi kriteri i mesatares jo domosdoshmërisht lidhet me meritokracinë edhe pse ky është një kriter që shihet si nxitës për të përmirësuar jetën para-universitare, sidomos konsideruar politikën e masivitetit që ndiqet në lidhje me kuotat e pranimit të studentëve në IAL.**

**Nota mesatare** dysheme e përcaktuar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave përbën risk që target grupi i studentëve me mesatare më të ulët të synojë studimin jashtë Shqipërisë duke qenë se ky kriter nuk aplikohet në të gjitha vendet. Gjithashtu, i aplikuar pa një strategji dhe në mënyrë të menjëhershme, kriteri i mesatares mund të ndikojë në raportin mësimdhënie-mësimnxënie apo dhe sjelljen ndaj një vlerësimi real të dijes në arsimin parauniversitar.

<sup>22</sup> Shih për shembull Neni 3 - Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë, Neni 4 - E drejta për arsimim, Neni 23 – Fakulteti, Neni 69 - Format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë, Neni 76- Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve, të ligjit 80/2015.



**Profesor Arben Bushgjokaj shprehet se** “mesatarja, nga kriter cilësie mund të kthehet në kriter abuzimi, pasi nxënësit që e kanë siguruar lehtësisht notën mesatare në shkolla ku ajo merret lehtë për arsye të ndryshme, të jenë fitues fiktivë të së drejtës për të hyrë në universitete.”



Sa i përket kriterit të notës mesatare, ekspertët janë të njëzëri se ajo duhet të vinte si pasojë e një studimi të të dhënave të mëparshme mbi pranimet në universitete. Kryesisht, ajo gjykohet si më e nevojshme të aplikohet për kalimin nga cikli i parë i studimeve (diploma ‘Bachelor’) në ciklin e dytë të studimeve (programet master) për të siguruar një hyrje të lirë dhe dalje sipas meritës nga universiteti.

**Degët me akses në ciklin master në mësuesi** kanë qenë më të prekura nga VKM-ja e kriterit të mesatares. Për vitin akademik 2016-2017,<sup>23</sup> 2017-2018<sup>24</sup> dhe 2018-2019<sup>25</sup> mesatarja ishte 6, ndërsa për vitin akademik 2019-2020 kjo mesatare u rrit në 6.5 (gjashtë pikë pesë)<sup>26</sup>. Për vitin akademik 2020-2021 për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë është minimalisht me notë mesatare 7.5 (shtatë pikë pesë) dhe për vitin akademik 2021 – 2022 e vijim është miratuar të shkojë në notën 8, ndërkohë që kjo mesatare për programet në tërësi është për vitin akademik 2020-2021 6.5 (gjashtë pikë pesë) dhe vitin akademik 2021 – 2022 e vijim është miratuar të jetë në notën 7.5 (shtatë pikë pesë).<sup>27</sup> Duhet theksuar se programet e studimit të ciklit bachelor në degët e mësuesisë janë programe që nuk diplomojnë mësues, pasi ky titull fitohet pas përfundimit të ciklit të dytë master. Kjo politikë shtetërore nuk ka ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësuesve, madje politika, sipas së cilës një gamë e gjerë e degëve të studimit të ciklit të parë cilësohen si degë që japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë, me justifikimin që ky është një profesion i rregulluar, po penalizon universitetet.



Sipas **Prof. Dr Anila Paparisto** “nëse shteti ka për qëllim të investojë për profesionin e mësuesit, i cili është edhe çelësi për ndryshimin e kombit duhet të mbështesë me bursë studentët e ciklit bachelor që vendosin të vijojnë studimet master për mësues dhe të risë të ardhurat e mësuesve në sistem.”

<sup>23</sup> VKM nr. 407, datë 1.6.2016. Shih në: <https://abz.gov.al/eli/vendim/2016/06/01/407>

<sup>24</sup> VKM Nr. 346, datë 19.4.2017. Shih në: <https://abz.gov.al/eli/vendim/2017/04/19/346>

<sup>25</sup> VKM Nr. 216, datë 20.4.2018, i ndryshuar. Shih në: <file:///C:/Users/eralda/Downloads/vendim-2018-04-20-216.pdf>


<sup>26</sup> VKM Nr. 295, datë 10.5.2019. Shih në: <https://abz.gov.al/eli/udhezim/2018/05/21/18>

<sup>27</sup> VKM nr. 436, datë 3.6.2020 „Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim“. Shih në: <file:///C:/Users/eralda/Downloads/vendim-2020-06-03-436.pdf>

## 4. Shërbimet studentore dhe administrimi financiar në IAL-të publike

Sipas Ligjit 80/2015, IAL-të publike vendosin tarifat e shkollimit,<sup>28</sup> duke respektuar kufirin maksimal të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Janë pikërisht Bordet e Administrimit të IAL-ve që miratojnë tarifat e shkollimit dhe shërbimeve për studentët pas vendimit të marrë nga Senati Akademik. Të ardhurat që përfitohen nga tarifat e shkollimit, regjistrimit, konkurrimit dhe të shërbimeve të tjera studentore administrohen tërësisht nga IAL-të dhe përbëjnë një të ardhur të rëndësishme për procesin mësimor, akademik, shkencor dhe administrativ të IAL-ve publike.

Sipas të dhënave të raportit të KLSH 2018 IAL-të subjekt auditimi, të ardhurat vetjake të përfituara kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe të shërbimeve ndaj studentëve, variojnë në diapazonin 27-51% kundrejt buxhetit total të IAL-ve.<sup>29</sup> Në varësi të masës së të ardhurave vetjake që sigurojnë IAL-të, përcaktohet numri i anëtarëve përfaqësues të IAL-ve në bordin e administrimit. Si rezultat i këtij përcaktimi ligjor, UT është i vetmi institucion i arsimit të lartë publik që ka katër anëtarë përfaqësues në bordin e administrimit të zgjedhur nga trupa akademike e tij, kundrejt tre anëtarëve përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin.



Buxheti i IAL-ve përbëhet nga të ardhurat vetjake që sigurojnë vetë IAL-të, granti për mësimdhënie i akorduar nga ministria përgjegjëse për arsimin, masa dhe

<sup>28</sup> Neni 3 - Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë, parashikon në pikën 3, germa ç) se 'autonomia financiare garantohet nëpërmjet së drejtës për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me këtë ligj', ndërsa neni 32 parashikon se IAL-të raportojnë për çdo vit akademik, pranë ministrisë përgjegjëse, tarifat e shkollimit për vitin në vijim.

<sup>29</sup> [http://klshe.org.al/web/03\\_sherbimet\\_studentore\\_4696.pdf](http://klshe.org.al/web/03_sherbimet_studentore_4696.pdf)



skema e financimit të të cilit përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe granti për kërkimin shkencor i akorduar po nga MASR. Megjithëse të ardhurat e IAL-ve publike nga tarifat e studentëve janë një e ardhur e konsiderueshme për buxhetin e tyre, konstatohet se shpenzimet e IAL-ve publike nuk orientohen në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj studentit apo kërkimit shkencor.



Ekspertët janë njëzëri të qëndrimit se niveli i ulët i cilësisë së shërbimeve studentore ndikon drejtpërdrejt në uljen e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Problematik gjithashtu mbetet edhe raporti tarifë – shërbim sidomos në nivelin e studimeve master, i cili nuk vjen si pasojë e një analize kostosh, por si një vendim i organeve drejtuese të IAL-ve për të përmbushur nevojat buxhetore të universiteteve thuhet në raportin e KLSH mbi tarifimin e shërbimeve studentore.<sup>30</sup>



**Dr. Blendi Ceka** referuar shërbimeve në sekretaritë e njësisë bazë shprehet se *“shërbimet studentore administrative duhet të kthehen në online për të eliminuar burkoracitë”*.

Mungesa e mundësive për të kryer kërkim shkencor dhe mësuar në laboratore bashkëkohore, sipas ekspertëve dhe të intervistuarve, i ka kthyer universitetet në zgjatime të shkollave të mesme. Sipas raportit të Qëndresës Qytetare 2019 me fokus investimet dhe nivelin e transparencës në raport me publikun dhe studentët për periudhën 15 shkurt deri më 31 tetor 2019 në 7 (shtatë) universitete publike, ato kishin shpenzuar 1.4 milion euro për zërin e buxhetit investime në 8 muaj, por vetëm 2900 euro për zërin e studimeve dhe kërkimeve (kjo shifër e fundit i përket Universitetit “Fan Noli” Korçë, ndërsa 6 universitetet e tjera kanë shpenzuar 0 lekë për këtë zë).<sup>31</sup>

Përveç ofrimit të mundësive të kërkimit shkencor, gjatë këtij studimi, përgjatë këtyre 5 viteve reformë në arsimin e lartë në universitetet publike, u vunë në pah edhe një sërë shërbimesh studentore të cilat janë problematike, deri në mungesë të plotë të ofrimit të shërbimit, të cilat po i listojmë më poshtë:

- Qasja në literaturë dhe materiale studimore në bibliotekat universitare,
- Qasja në laboratore dhe salla leksionesh bashkëkohore,
- Qasja në pajisje IT dhe internet,
- Qendrat e këshillimit të karrierës,
- Informimi dhe orientimi fillestar i studentëve të viteve të para,
- Kujdesi shëndetësor,
- Ambiente dhe hapësira sportive dhe argëtimi,
- Zyrat e alumnit,
- Burimet mbështetëse për personat me aftësi ndryshe,

<sup>30</sup> [http://ksh.org.al/web/03\\_sherbimet\\_studentore\\_4696.pdf](http://ksh.org.al/web/03_sherbimet_studentore_4696.pdf)

<sup>31</sup> Raport Studimor 'Transparenca dhe menaxhimi financiar në Universitetet Publike Viti akademik 2018 – 2019'. Shih në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/15931.pdf>

- Qendrat e Këshillimit për "Erasmus Mundus".

Aktualisht, në ambientet universitare vijojnë të ofrohen shërbimet bazike të nevojshme për studentët si: mësimdhënia, sekretaria mësimore, biblioteka elektronike dhe trajtimi në konvikte.

## 5. Liria dhe promovimi akademik

Në letër, ligji 80/2015 parashikon një liri më të madhe për IAL-të në krahasim me ligjin e vitit 2007. Tashmë IAL-të mund të vendosin vetë për mënyrën e financimit dhe shpenzimit, kuotat e studentëve që do të pranojnë, kriteret e pranimit, procesin e punësimit të personelit akademik apo profilizimin e tyre në afatgjatë. Një nga aspiratat e këtij ligji ishte pikërisht rritja e konkurrencës pozitive midis IAL-ve, si bazë e liberalizimit të shërbimeve studentore. Edhe ndarja e procesit akademik nga ai administrues në universitete, duke i hapur rrugë ndarjes së qartë të përgjegjësisë, në frymën e ligjit shihet si dimension i shtimit të lirisë, pasi Rektorët mund të përqëndrohen në aspektet akademike, duke u çliruar nga administrimi financiar, kompetencë që i njihet Administratorit.<sup>32</sup>



Pavarësisht parashikimeve ligjore në këtë drejtim ekspertët janë të mendimit se në praktikë ligji i Arsimit të Lartë është zbatuar jo në funksion të respektimit të lirisë akademike nga MASR dhe vetë universitetet.



*"Ministria është përpjekur vazhdimisht ta "sabotojë" këtë ligj, duke centralizuar ku dhe sa mundet proceset universitare. Nga ana tjetër, Rektorët, Senatet, Administratorët dhe Bordet e Administrimit janë futur në konflikte të panevojshme dhe nuk kanë marrë përgjegjësitë e veta", shprehet **Dr. Rinald Muça**.*



Ndërsa **Prof. Asoc. Dr. Afrim Krasniqi** lidhur me lirinë akademike që ofron ligji 80/2015 shprehet se me këto ndarje kompetencash *"Pedagogu është më i pavarur në aktivitetin e tij, departamenti ka më shumë forcë dhe disa tentativa shkarkimi të Rektorëve e Dekanëve nga qeveria kanë dështuar."*

<sup>32</sup> Shih Neni 51- Administratori i institucionit të arsimit të lartë, i ligjit 80/2015.

**Kërkimi shkencor**, i cili duhet të jetë veprimtari bazë e personelit akademik, gjatë 5 viteve të zbatimit të ligjit 80/2015 ka hasur barriera financiare, ligjore dhe burokratike, duke çuar në uljen e numrit dhe cilësisë së punimeve shkencore në vend. Pedagogët shprehen se fondet për të realizuar kërkim janë të pamjaftueshme ose nuk vijnë deri tek ata.



*"Edhe nesë ka fonde të brendshme në një vit si pasojë e të ardhurave nga studentët, mungojnë praktikat ligjore dhe instrumentat për t'i orientuar ato për kërkim në terren."* thotë **Dr. Blendi Ceka**.



Ndërsa **Dr. Merita Poni** shprehet se mungojnë fondet për projektet shkencore dhe pedagogët nuk paguhen për këto projekte: *"Kemi mbyllur edhe revistat shkencore se nuk paguajmë dot as bordin, as redaktuesit shkencorë dhe letrare, dhe as kontribuesit."*

Problemi i financimit të kërkimit shkencor shfaqet edhe tek **doktoraturat**, si formë e promovimit akademik. Ligji ka vendosur kufizime për numrin e doktorantëve që mund të udhëheqë një profesor, afate të qarta për fazat e doktorimit dhe publikimet sipas çdo faze, duke promovuar kështu de jure cilësinë e kërkimit akademik. Problemi i financimit të doktoraturave apo titujve akademikë në përgjithësi është një ngërç i zbatimit të Ligjit, të ciin IAL-të nuk po e konsiderojnë pothuajse fare. Doktorantët duhet ta financojnë pothuajse çdo gjë vetë duke filluar nga publikimet në revista shkencore, ndjekjen e nje konference dhe qasjen në literaturë. Situatë e njëjtë është edhe në rastet e rrugëtimit për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i Asociuar' dhe 'Profesor'.

Lidhur me lirinë e IAL-ve për të ndryshuar dhe përshtatur **kurrikulat**, ekspertët e pyetur në këtë studim janë të ndarë: një pjesë mendojnë se mundësia për të ndryshuar deri në 20% përmbajtjen e kurrikulës është e mjaftueshme, pasi me ndryshimin në një masë më të madhe program i studimit logjikisht nuk është më i njëjti. Pjesa tjetër e ekspertëve shprehen se në kuadër të autonomisë universitetet duhet të kenë mundësi 40% të pavarur nga vendimmarrja e MASR për të ndikuar dhe ndryshuar kurrikulat universitare.



## 6. Etika dhe integriteti akademik

Gjatë periudhës 2015 – 2018 të zbatimit të ligjit për arsimin e lartë pati pak ose aspak debate lidhur me integritetin dhe etikën akademike, me përjashtim të rasteve të denoncuara për korrupsion dhe rryfshet në ambientet akademike. Rregulloret dhe aktet nënligjore të shumë IAL-ve publike dhe njërive bazë ende nuk janë përditësuar me kompetencat e ligjit, dhe Këshillat e Etikës kanë pasur një rol dhe aktivitet të ulët sa i përket ankesave dhe gjykrimeve për çështje që lidhen me integritetin akademik të stafëve akademike.

Gjatë protestës studentore në dhjetor 2018, një nga 8 kërkesat e studentëve ishte edhe “Rishikimi i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore”, kërkesë e cila lidhej drejtpërdrejt me cilësinë e mësimdhënies dhe nivelit të stafit akademik. Qeveria shqiptare, e ndodhur nën presion, e adresoi këtë çështje në Paktin për Universitetin, i cili u publikua në fillim të vitit 2019, si një dokument politikash për ndryshimin e sistemit arsimor.<sup>33</sup>

**VENDIM**  
Nr. 99, datë 5.2.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 777, DATË 26.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KONTROLLIN ANTIPLAGJIATURË TË DISERTACIONEVE PËR FITIMIN E GRADAVE SHKENCORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “e”, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“4. Institucionet e arsimit të lartë kryejnë kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”;

b) pika 6 shfuqizohet;

c) pika 7 ndryshohet, me këtë përmbajtje:  
“7. Institucionet e arsimit të lartë njoftojnë ministrinë përgjegjëse për arsimin, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar, për rezultatet e gjetjeve nga kontrolli antiplagjiaturë dhe masat e marra pas rivlerësimit përfundimtar për gradën shkencore të dyshuar si plagjiaturë.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR  
**Erion Brace**

Në 26 dhjetor 2019 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 777 “Për kontrollin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, e cila ngarkonte Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me përgjegjësinë e krijimit të arkivit digjital të disertacioneve të përdorura për fitimin e gradave shkencore në institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik si dhe kryerjen e kontrollit digjital antiplagjiaturë të

disertacioneve, parashikim që solli reagime të shumta për cenim të autonomisë së IAL-ve. Madje, kjo VKM e ngarkoi këtë ministri me sigurimin e softwar-ëve për kontroll automatik si dhe programe apo pajisje të tjera që i shërbenin këtij qëllimi.<sup>34</sup> Në krye të një periudhë 1 – vjeçare, në dhjetor 2019, në reflektim edhe të presionit të vazhdueshëm të studentëve dhe organizatave të shoqërisë civile,

<sup>33</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/DRAFT-PAKTI-PER-UNIVERSITETIN.pdf>

<sup>34</sup> [Shih tekstin e VKMsë në: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/12/26/777](https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/12/26/777)

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë bleu soft-in “Platforma Akademia”, një sistem antiplagjiaturë në vlerën 20mijë euro të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.<sup>35</sup>

Më 14 janar 2020 Ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nëpërmjet Urdhërit nr.8 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”,<sup>36</sup> urdhëroi që universitetet, para procesit zgjedhor, nëpërmjet këshillave të etikës të verifikonin ligjshmërinë e fitimit të titujve akademikë për kandidatët, duke përfshirë edhe kontrollin anti-plagjiaturë.<sup>37</sup> Ky veprim, së pari ktheu në pikën zero premtimin dhe iniciativën e ndërmarrë në kuadër të paktit për universitetin, së dyti, pati raste që instrumenti u keqpërdor për të eliminuar kandidatët që mund të rivalizonin rektorët dhe dekanët aktualë apo edhe për të penguar denoncime përmes aspekteve burokratike procedurale. Mungesa e instrumenteve të qartë administrative për kontrollin e ushtrimit të këtij mekanizmi, apo edhe e rregullimeve të lehtësuara procedurale për raportimin e rasteve të plagjiatuarave, bënë që ky mekanizëm të mos ushtrohet ende aktivisht nga ana e IALve.

Gjatë vitit 2020, si një vit zgjedhor në universitete, MASR parashikoi që organet drejtuese të institucioneve të arsimit të lartë duhet të realiznin procesin e garantimit të integritetit akademik të të gjithë kandidatëve që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 30 korrikut.” Kjo dispozitë nënkupton faktin se çdo kandidat duhet t’i nënshtrohej kontrollit anti-plagjiaturë dhe verifikimit të titujve shkencorë dhe rezultatet të ishin pjesë e dosjes së tij të kandidimit.

**FORMULAR VETËDEKLARIMI**  
NË ZBATIM TË RREGULLORES

**“PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET  
DREJTUESE DHE SENATIN AKADEMIK NË UNIVERSITETIN  
ALEKSANDËR MOISIU”**

Në mbështetje të Nenit 18/19/20/21 të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe senatin akademik në Universitetin Aleksandër Moisiu”, unë....., kandidat për postin....., deklaroj nën përgjegjësinë time për mungesën e plagjiaturës në punimet për fitimin e Gradës/Titullit shkencor.

Emër Mbiemër

Universitetet publike, të dakordësuara në heshtje, sollën një instrument të ri, si risi në rregulloret e tyre për organizimin e e zgjedhjeve, të paparashikuar në VKM nr. 777, apo në Urdhrin e janarit 2020 të Ministres së Arsimit, i cili u quajt **“Formulari i Vetëdeklarimit Anti-Plagjiaturë”**.

Universitetet publike parashikuan në unison në Rregulloret e tyre të zgjedhjeve se çdo kandidat për organet drejtuese duhet të ketë plotësuar këtë formular, duke anashkaluar kontrollin anti-plagjiaturë dhe verifikimin e titujve akademikë si hallka të rëndësishme për integritetin akademik të pedagogëve dhe drejtuesve.

<sup>35</sup> <https://akademia.al/>

<sup>36</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Urdher-nr-8-dt-14.1.2020-zgjedhje.pdf>

<sup>37</sup> <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Urdher-nr-8-dt-14.1.2020-zgjedhje.pdf>

Gjithashtu, me ndryshimin që iu bë VKMsë nr.777 të vitit 2019, me VKM 99, datë 5.2.2020, tashmë parashikohet se janë vetë IALtë që kryejnë kontrollin digjital antiplagjiaturë të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<sup>38</sup>



Ekspertët shprehen se çështja e plagjiaturës duhet të lidhet ngushtë me etikën në universitete, të cilat duhet të kenë aktet e tyre të brendshme në lidhje me këtë problematikë.



*“Duhet kuptuar që Ligji dhe aktet nënligjore që miraton MASR nuk mund ta shterojnë një proces që është përgjegjësi e vetë IAL-së, në kushtet kur IAL-të gëzojnë autonomi akademike. Vetë IAL-të duhet të jenë shumë aktive në çështjet e etikës së kërkimit shkencor dhe të parashikojnë rregulla të qarta për këtë çështje në statutet e tyre, nëse i kanë miratuar”, shprehet Dr. Rinald Muca.*

## 7. Akreditimi i programeve të studimit

Ligji nr.80/2015, përcaktoi krijimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), për realizimin e procesit të vlerësimit për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe të programeve të studimit që ato ofrojnë, si dhe monitorimin në vijimësi të cilësisë së tyre. Organizimi dhe funksionimi i ASCAL-it, sipas ligjit (neni 136), u parashikua të rregullohej me Vendim të Këshillit të Ministrave. Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit do të duhej të riorganizohet në ASCAL.<sup>39</sup> Bazuar në ligj, procesi i sigurimit të jashtëm të cilësisë, akreditimit institucional dhe programeve të studimit do vijonte sipas kuadrit ligjor ekzistues, deri në riorganizimin e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë si ASCAL dhe miratimit të Kodit të Cilësisë. Riorganizimi i Agjencisë Publike të Arsimit të Lartë (APAAL) në ASCAL, u realizua bazuar në VKM Nr.109, datë 15.2.2017,<sup>40</sup> pra 18 muaj pas miratimit të ligjit dhe jo 9 siç parashikohej në nenin 141 të ligjit.

Pranë ASCAL-it, parashikohej ngritja dhe funksionimi i Bordi të Akreditimit si organ kolegjal i pavarur vendimmarrës për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit. Riorganizimi nga Këshilli i Akreditimit

<sup>38</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/02/05/99>

<sup>39</sup> Shiko VKM Nr.109, datë 15.02.2017. Ky akt nënligjor u miratuar 18 muaj pas miratimit të ligjit dhe jo 9 muaj sic parashikohej në nenin 141 të ligjit.

<sup>40</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/15/109>



në Bordin e Akreditimit u bë duke i dhënë këtij institucioni/organi më shumë pavarësi në vendimarrje.

Akreditimi institucional është procesi i çertifikimit të cilësisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, ndërsa akreditimi i programeve të studimit është procesi i certifikimit të cilësisë së tyre, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, në të cilin përcaktohen standardet shtetërore të cilësisë, të detyrueshme për zbatim prej institucioneve të arsimit të lartë. Ky dokument hartohet nga ASCAL dhe ministria përgjegjëse për arsimin dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky kod duhej të miratohej brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji<sup>41</sup>, por u miratua 2 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit, vonesë e cila paralizoi për një kohë të gjatë këtë proces.<sup>42</sup>

ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike për Sigurimin e Cilësisë (Quality Assurance Agency - QAA)<sup>43</sup> filluan në vitin akademik 2016 – 2017 procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Në këtë proces akreditimi u përfshinë 36 IAL në Shqipëri (publike dhe private), nga të cilat 21 IAL ishin universitete (12 publike dhe 9 private), 10 institucione të arsimit të lartë/kolegje universitare (private), 2 akademi (1 publike dhe 1 private) dhe 1 ishte kolegji profesional privat.<sup>44</sup> Gjithsej, 13 institucionet publike iu nënshtruan vlerësimit institucional. Nga fillimi i procesit të akreditimit institucional deri në qeshor 2020 u realizua akreditimi institucional në 13 institucione publike, 25 institucione private dhe 303 programe nga 1374 gjithsej (924 publike dhe 450 private).



Ekspertët shprehen kritikë në aspektin e akreditimit të programeve të studimit duke i targetuar si procese që nuk ndikojnë sa duhet në politikën institucionale.

<sup>41</sup> Shiko VKM nr.531, datë 11.09.2018. Ky akt nënligjor u miratuar tre vjet pas miratimit të ligjit dhe jo 1 vit sic parashikohej në nenin 141 të ligjit.

<sup>42</sup> VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 "Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë". Shih në: <https://qaz.gov.al/eli/vendim/2018/09/11/531>

<sup>43</sup> Bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit, nënshkruar në Dhjetor 2014, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë dhe Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA) të Mbretërisë së Bashkuar, dhe të Kontratës së Përgjithshme të Projektit ndërmjet QAA-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

<sup>44</sup> Sipas Raportit përfundimtar të vlerësimit "Për ofrimin e ekspertizës për sigurimin e cilësisë në mbështetje të krijimit të materialeve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, trajnimit të ekspertëve vlerësues të jashtëm dhe ekspertizës në mbështetje të vlerësimit të jashtëm të institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri", mars 2018.



## 8. Të drejtat e studentëve në universitete

### 8.1 Pesha e votës dhe përfaqësimi i studentëve në zgjedhjet në universitete dhe Bordet e Administrimit

Krahasuar me ligjin e vitit 2007 për arsimin e lartë, ligji 80/2015 parashikoi një ulje të **peshës së votës së studentëve** në zgjedhjet për organet drejtuese akademike nga 20% në 10%. Si pasojë e kësaj tkurje, në zgjedhjet e vitit 2016 studentët ishin pak ose aspak vendimmarrës në zgjedhjen e rektorëve apo dekanëve. Në vitin 2018 gjatë protestës studentore një nga kërkesat e artikuluara ishte rritja e peshës së votës në masën 50%, kërkesë e refuzuar nga qeveria si e pabazuar në një precedent ndërkombëtar. Ndryshimi në peshën e votës në vendimmarrjen për zgjedhjen e përfaqësuesve akademikë është në dispropocion me masën që zënë subjektet që përbëjnë universitetin, ku studentët janë rreth 90% e popullatës si edhe përfituesit kryesorë të shërbimeve dhe vendimmarrjes, ndërsa pedagogët rreth 10% e popullatës. Pesha e votës së tyre në zgjedhje është e kundërta. Për ilustrim, aktualisht në Universitetin e Tiranës vota e 1 pedagogu vlen sa vota e 314 studentëve dhe në Universitetin "Aleksandër Moisiu" të Durrësit vota e 1 pedagogu vlen sa 456 studentë.



Sipas ekspertëve të përfshirë në këtë studim, pesha e votës së studentëve duhet të lidhet më peshën vendimmarrëse të tyre brenda institucionit. Si aktorë kryesorë të marrjes së shërbimit, ata duhet të kenë një peshë më ndikuese në zgjedhjen e drejtuesve dhe organeve drejtuese në IAL.

Në datën 22 korrik 2020, me nxitjen e Qëndresës Qytetare, bazuar në analiza të zgjedhjeve të politikës së vendeve të tjera si dhe precedentëve vendas, u depozitua nga një deputete në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nisma ligjore "Për disa ndryshime në ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Sipas kësaj nisme propozohet rritja e peshës së votës së studentëve në zgjedhje dhe përfaqësimi në organet drejtuese në masën 30%.<sup>45</sup>

Sipas ligjit 80/2015, **Bordet e Administrimit**<sup>46</sup> përbëhen nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së. Nëse institucioni i arsimit të lartë siguron vetë 50% (pesëdhjetë për qind) ose më shumë të buxhetit afatmesëm, katër prej

<sup>45</sup> [https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200724115551Scan\\_20200724\\_114246\\_compressed.pdf](https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200724115551Scan_20200724_114246_compressed.pdf)

<sup>46</sup> Shih veçanërisht nenet 47-49 të Ligjit 80/2015.

anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe tre janë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Në rastet kur institucioni siguron vetë më pak se pesëdhjetë për qind të buxhetit afatmesëm, tre prej anëtarëve janë përfaqësues të IAL-së dhe katër janë përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin. Sot, nga gjithë IAL-të publike, vetëm Universiteti i Tiranës ka një shumicë nga përfaqësues të Universitetit.

Më 26.12.2018 u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 782 "Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në Institucionet publike të Arsimit të Lartë".<sup>47</sup> Si rezultat i kësaj VKM-je emërimet e reja do të bëheshin me një proces të hapur dhe me vëmendje publike dhe njëri prej anëtarëve që emërohet prej MASR, të ishte propozim **i studentëve** por një figurë publike, sipas kërkesës së ligjit. Referuar këtij akti nënligjor, më 9 shkurt 2019, MASR shpalli konkursin për Anëtarët e Bordit, përfaqësues të MASR dhe studentëve, por për shkaqe ende të pa bëra publike ky proces u shty tri herë për ri-aplikim dhe zgjati rreth 1 muaj e gjysëm.<sup>48</sup>

Votimet e studentëve për anëtarët e Bordeve të Administrimit u shoqëruan me mungesë transparence dhe pjesëmarrje. Në universitetin më të madh në Shqipëri, atë të Tiranës morën pjesë vetëm 11% e studentëve në votime për Bordet e Administrimit, ndërsa në atë të Mjeksësisë, Tiranë vetëm 1.33%. Mungesa e rregullave të qarta, jo diskreciale, mbi procesin e votimeve për anëtarë bordi solli cënim të së drejtës së votës, pasi Ministri i Arsimit zgjodhi një nga 3 kandidaturat pavarësisht numrit të votave që ka grumbulluar ajo kandidaturre, kjo bazuar në kompetencën diskreciale që Vendimi nr. 782, datë 26.12.2018 i jep ministrit përgjegjës për arsimin.<sup>49</sup> Pra, procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Bordeve të Administrimit bazohet në përzgjedhje me karakter të fortë diskrecial dhe jo në bazë të votave.

Për ta ilustruar dhe vënë në dukje këtë problematikë i referohemi votimeve të realizuara në Universitetin "Fan Noli" në Korçë dhe atë Luigj Gurakuqi Shkodër, ku Ministria e Arsimit urdhëroi emërimin e kandidatit që kishte më pak vota studentësh duke cënuar demokracinë dhe vullnetin e votave të studentëve.<sup>50</sup>

<sup>47</sup> <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/12/26/782>

<sup>48</sup> <https://arsimi.gov.al/shtyhet-afati-i-aplikimit-per-anetar-te-bordit-te-administrimit-ne-institucionet-publike-te-arsimit-te-larte-si-perfaqesues-te-ministrise-se-arsimit-sportit-dhe-rinise-deri-me-date-26-03-2019/>

<sup>49</sup> Vendimi nr. 782, datë 26.12.2018 i ka njohur qartazi në pikat 13 dhe 14 diskrecion ministrit përgjegjës për arsimin për emërimin e anëtarët e bordit për secilin institucion të arsimit të lartë nga lista e cilitdo prej atyre që plotësojnë kriteret për të qenë anëtarë bordi.

<sup>50</sup> Vendim i Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, nr. 279, datë 16.5.2019, nr.Prot. 933 dhe Urdhër i Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë nr. 726, datë 7.6.2019, "Për lirimin nga detyra të anëtarëve të Bordit të Administrimit të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë dhe emërimin në detyrë të anëtarëve të rinj, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin".

## 8.2 Sistemi i vlerësimit pedagog – student dhe anasjellas

Ligji nr.80/2015 përcakton kryerjen e procesit të vlerësimit të mësimdhënies, çdo tre vjet, si dhe, monitorimin në mënyrë të vazhdueshme të institucioneve të arsimit të lartë, përmes Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në bashkëpunim me Bordin e Akreditimit kanë përgjegjësinë e realizimit të këtij procesi. ASCAL është institucioni përgjegjës që harton procedurën, metodologjinë dhe instrumentet për zhvillimin e SKS.<sup>51</sup>

Institucionet e Arsimit të Lartë kanë detyrim ligjor që t'i nënshtrohen SKS, si proces i cili bazohet në vlerësimin e studentëve për elementet e procesit mësimor. Studentët duhet të jenë të organizuar dhe përfaqësuar nga Këshillat Studentorë.

Institucionet e arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit dhe realizimit të mbarëvajtjes së cilësisë së programeve të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve dhe kompetencave të përfutuara nga programi përkatës.

MASR e realizoi Sondazhin Kombëtar të Studentëve për herë të parë në muajt prill – maj 2019, pra 4 vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe nën presionin e protestës studentore. Pyetësori u hartua nga Bordi i Akreditimit i përbërë nga 11 profesorë. U shpërndanë 89 mijë pyetësorë në nivel kombëtar dhe mesatarisht u plotësuan 31,2%. Shumica e studentëve u shprehën të pakënaqur nga mbështetja institucionale e IAL-ve dhe relativisht të kënaqur nga mësimdhënia e pedagogëve. 52% kishin "pritshmëri të paplotësuar" nga institucionet ku ata studiojnë, 45% e tyre u shprehën se nuk zhvillohen pyetësorë për cilësinë e mësimdhënies, 55% e tyre u shprehën se infrastruktura është e pamfjaftueshme, dhe 66% e tyre u shprehën se personeli akademik është kompetent. Ky proces anashkaloi dy zotime që synonte të adresonte ndaj studentëve, të artikuluar masivisht në protestën e studentëve në dhjetor 2018: trajtimi i fenomenit të korrupsionit në universitete dhe krijimi i dosjeve të pedagogëve sipas vlerësimit nga studentët në këtë sondazh.

Pavarësisht se rezultatet e plota të Sondazhit nuk janë bërë ende publike, studentët në pyetësor nuk kanë pasur mundësi të shprehen në asnjë pyetje për raste individuale të korrupsionit pasiv, të mungesës së etikës në mësimdhënie dhe të vlerësojnë pedagogët në mënyrë që në bazë të rezultateve të krijohen dosjet e tyre personale.

<sup>51</sup> Neni 104- Sigurimi i jashtëm i cilësisë i Ligjit 89/2015 si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.109, datë 15.2.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë". Shih vendimin në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/15/109>



Ekspertët në këtë studim shprehen njëzëri se “Vlerësimi i pedagogëve nga ana e studentëve duhet të jetë një praktikë e padiskutueshme dhe reale në universitetet tona dhe, në çdo rast, studentët duhet të jenë në dijeni të rezultateve të vlerësimit. Mungesa e informimit e bën jo shumë të vlefshëm këtë proces. Vlerësimi i studentëve nuk mund të bëhet vetëm në funksion të akreditimit, ai duhet të jetë në funksion të cilësisë së mësimdhënies.”

## 9. Ligji 80/2015, nevojë për përmirësim apo ndryshim

Ligji 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë u projektua për të sjellë ndryshime thelbësore në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë. Pavarësisht se ky ligj pati një varg konsultimesh dhe kontestimesh, u miratua me shumicë votash në Kuvend<sup>52</sup> edhe pas rikthimit nga Presidenti<sup>53</sup>.

Ligji u publikua në Fletoren Zyrtare më 21.09.2015 dhe në dispozitën e fundit të tij parashikohej se aktet nënligjore do të dilnin **brenda 9 muajsh** nga hyrja në fuqi e ligjit, pra në fundin e muajit qershor 2016.



Nga të dhënat zyrtare të marra mbi bazën e ligjit mbi të drejtën e informimit nga MASR si dhe paralelisht nga verifikimet në publikimet e rregullta në Fletoren Zyrtare në Republikën e Shqipërisë rezulton se në afatin zyrtar u miratuan **vetëm dy nga të paktën 34 akte të prishme nënligjore**.<sup>54</sup> Konkretisht, në dhjetor 2015 u miratua akti lidhur me KALKSH (Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor) dhe në fillimin e muajit gusht 2016 vendimi për

<sup>52</sup> <https://www.parlament.al/Files/LigjeRishqyrtim/fv16.pdf>

<sup>53</sup> Dekret nr. 9206, date 14.10.2015. Shih në: <http://president.al/old/presidenti-nishani-dekretion-kthimin-per-rishqyrtim-ne-kuvend-te-ligjit-nr-802015/>

<sup>54</sup> Sipas nenit 141 të Ligjit 80/2015 janë 34 akte nënligjor të listuara për t'u miratuar, ndërkohë ligji në nene të ndryshme të tij përfshin edhe detyrimin e miratimit të akteve nënligjore të cilat nuk i ka përfshirë në nenin 141.



procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucionet jashtë vendit.



Referuar të dhënave të marra nëpërmjet të drejtës së informimit dhe verifikimeve në Fletoren Zyrtare rezulton se gjatë vitit 2016 u miratuan edhe **dy akte**, VKM 607 dhe VKM 903 që kishin të bënin me statusin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) si dhe me kriteret për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore.



Gjatë vitit 2017, rreth 6 deri në 17 muaj pas përfundimit të afatit ligjor, u miratuan një sërë aktesh të tjera nënligjore, si VKM 397 për AKFAL, VKM 109 mbi ASCAL, VKM 329 për statusin e personelit akademik, VKM 418 për kriteret e procedurat për hapjen apo mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe udhëzimi 31 mbi kriteret e procedurat në vijim të kësaj VKM-je, etj.



Gjatë vitit 2018, pra rreth 17 deri në 27 muaj jashtë afatit ligjor të ligjit 80/2015, u miratuan aktet e tjera nënligjore si VKM 698 mbi tarifatat e shkollimit për disa kategori, VKM 112 për kriteret për fitimin e gradës dhe titujve shkencorë, VKM 560 për tarifatat nga QSHA, udhëzimi nr. 5 mbi elementët e raportimit vjetor të IALve, VKM 41 për programet e studimit, VKM nr. 88 për krijimin e RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar), udhëzimi nr.7 për kontratat e studentit në universitetet jopublike, VKM 531 për Kodin e Cilësisë, Udhëzimi nr. 6 për numrat e matrikullimit.



Gjatë vitit 2019, në periudhë kohore 27 deri në 43 muaj pas afatit ligjor, u miratua edhe VKM për kartën e studentit dhe Urdhri 396 për riorganizimin e programeve të studimit Bachelor. Viti 2019 pati edhe disa akte administrative shtesë që nuk kishin lidhje të drejtpërdrejtë me ligjin 80/2015, por me Paktin e Universitetit pas protestave studentëve në dhjetor 2018 dhe janar 2019.



Aktualisht, në vitin 2020, kur ligji ka 5 vite zbatim, mungojnë ende akte të rëndësishme nënligjore, si:

- ✘ 1. VKM "Për specifikat e funksionimit të arsimit të lartë jolaik" (është hartuar një draft paraprak) (Neni 5, pika2);
- ✘ 2. VKM "Struktura dhe organizimi i qendrave ndërinstitucionale". (Neni 96)<sup>55</sup>

<sup>55</sup> Është miratuar vetëm një akt administrativ që krijon një qendër të tillë, VKM nr. 88, datë 14.02.2018 "Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)".

- ✘ 3. VKM “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi”. (Neni 114).
- ✘ 4. VKM “Për kushtet që duhen plotësuar nga IAL-të publike për aplikimin për kredi” (Neni 115);
- ✘ 5. VKM “Për përcaktimin e procedurës dhe dokumentacionit për krijimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik të Pavarur (IALPP)” (Neni 120);
- ✘ 6. VKM “Specifikimet për kodifikimin e programeve të studimit (Neni 125);
- ✘ 7. Udhëzim “Procedurat për kodifikimin dhe riorganizimin e programeve të studimit” (Neni 86);
- ✘ 8. Udhëzim “Mbi frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit” (Neni 87).

Mungesa e akteve nënligjore për një kohë të gjatë krijoi çoroditje, përplasje mes strukturave dhe mbivendosje të kompetencave. Gjithashtu, kjo vonesë i la universitetet për një kohë të gjatë pa statute dhe rregullore të përditësuara me ligjin 80/2015, si dhe solli bllokimin e procesit të studimeve në ciklin e tretë (master ekzekutiv dhe doktoraturë).



*Mungesa e akteve nënligjore apo mospërputhja e tyre me vetë frymën e ligjit bëri që ligji të mos funksionojë për një kohë të gjatë, dhe kjo ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë nën efektet anësore të tij duke e çuar sistemin në një pikë delikate, shprehet **Prof. Dr Anila Paparisto**.*

Megjithëse ligji 80/2015 ka hyrë në vitin e pestë të zbatimit të tij debatet mbi ekzistencën, përmirësimin apo rrëzimin e tij kanë vijuar nga aktorë të ndryshëm shoqërorë, akademikë dhe politikë.



Tashmë, pesë vjet pas hyrjes në fuqi të tij ekspertët shprehen të ndarë sa i takon të ardhmes së ligjit 80/2015. **Një pjesë e tyre shprehen se ky është një ligj i mirë** që siguron mundësi për zhvillim, llogaridhënie, balancë të bazuar në llogaridhënie, meritokraci, çon më shumë vendimmarrje në njësinë bazë dhe rrit autonominë, por IAL-të, drejtuesit e tyre dhe vetë

ministra nuk e ka përthithur në masën dhe kohën e duhur, si nga ana e zbatimit ashtu edhe e përmbajtjes.



*Ligji u përpoq të ndryshonte mendësinë e atyre që janë të angazhuar në këtë sektor, por ndryshimi i kulturës nuk vjen thjesht me ligje, vjen së pari me vullnet për të përmirësuar shoqërinë dhe menduar për të ardhmen e brezave, **shprehet Dr. Rinald Muça.***

**Pjesa tjetër e ekspertëve** janë pro **rishikimit të ligjit** në kuadër të përmirësimit të aspekteve që lidhen me financimin, administrimin, konkurrencën dhe garantimin e cilësisë, **me** qëllim adresimin më mirë të realitetit të Shqipërisë dhe sfidave të së ardhmes, duke e cilësuar ligjin 80/2015 si të papërshatshëm për nevojat universitare.




*"Ligji 80/2015 e përfshin në logjikën e tregut universitetin publik, pra mbizotëron aspekti ekonomik mbi atë akademik, dhe vendos si parim kryesor marrëdhënien ndërmjet pagës së pedagogut, numrit të studentëve dhe numrit të programeve të studimit. Në këtë mënyrë nxit garën për mbijetesë në kurriz të cilësisë, duke përkeqësuar standardet akademike", **shprehet Dr Blendi Ceka.***

## 10. Gjetjet kryesore



- Procesi i pranimeve në universitete vijon të jetë i centralizuar edhe pse Ligji 80/2015 garanton autonominë e universiteteve për mbarëvajtjen e procesit pranues të studentëve.



- Nota mesatare dysheme e përcaktuar nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave mund të ndikojë në raportin mësimdhënie-mësimnxënie apo dhe sjelljen ndaj një vlerësimi real të dijes në arsimin parauniversitar.



- Ligji 80/2015 synonte rritjen e cilësisë dhe shërbimeve që universitetet publike duhet të ofrojnë për studentët, por shpenzimet e universiteteve publike në 5 vite nuk janë orientuar në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj studentit apo drejt kërkimit shkencor.



- Autonomia financiare që ligji 80/2015 u dha IAL-ve publike nuk ndikoi në rritjen e financimit për kërkimin shkencor. Financimi i kërkimit shkencor për pedagogët në këto 5 vite ka qenë shumë i ulët për shkak të barrierave financiare, ligjore dhe burokratike. Doktorantët, dhe pedagogët për marrjen e titujve, duhet të financojnë vetë publikimet në revista shkencore, ndjekjen e konferencave dhe qasjen në literaturë.



- Ligji 80/2015 synonte krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm të brendshëm dhe të jashtëm të kontrollit akademik, por MASR dhe universitetet publike dështuan të realizojnë kontrollin anti – plagjiaturë dhe verifikimin e titujve shkencorë të parashikuar edhe në VKM-në nr. 777.



- Pavarësisht se aktet nënligjore duhet të dilnin 9 muaj pas hyrjes së ligjit në fuqi, rezultoi se në afatin zyrtar u miratuan vetëm dy akte nga të paktën 34 akte të pritshme nënligjore.



- Mungesa e akteve nënligjore për një kohë të gjatë krijoi çoroditje, përplasje mes strukturave dhe mbivendosje të kompetencave. Kjo vonesë i la universitetet për një kohë të gjatë pa statute dhe rregullore të përditësuara me ligjin 80/2015 apo edhe pa mundësinë e realizimit të të gjitha cikleve të studimit sipas vetë ligjit. Mes akteve nënligjore ka të atilla që bien ndesh edhe me vetë ligjin.



## 11. Rekomandime



- Kriteret e pranimit në IAL-të publike, kuota dhe mesatarja në kuadër të autonomisë akademike, duhet të vendosen dhe të aplikohen nga vetë universitetet. IAL-të gëzojnë me ligj të drejtën e përcaktimit të kriterëve specifike të pranimit. Këto kriterë pranimi mund të jenë konkurruese me kriterin e notës mesatare dysheme të miratuar me VKM.




- Kriteri i notës mesatare duhet të vijë si pasojë e një studimi të të dhënave të mëparshme mbi pranimet në universitete dhe është më e nevojshme të aplikohet për kalimin nga cikli i studimeve bachelor në ciklin master duke siguruar një hyrje të lirë dhe dalje sipas meritës nga universiteti. Politikat arsimore duhet të ndërmerren të bazuara në nevoja reale, të koordinuara dhe të plota.



- Universitetet dhe njësitë bazë duhet të përpilojnë dhe miratojnë rregulloret e brendshme të bazuara në ligjin 80/2015 për të garantuar shërbime më cilësore dhe sistem efektiv ankesash për studentët. Të gjitha shërbimet studentore administrative duhet të dixhitalizohen për të eleminuar burkoracitë dhe vonesat.



- Në kuadër të autonomisë akademike dhe frymës që synonte ligji 80/2015 për autonominë akademike, universitetet duhet të kenë shkallë më të madhe pavarësie nga vendimmarrja e MASR për të ndikuar dhe ndryshuar kurrikulat universitare.



- IAL-të publike duhet të jenë më aktive në çështjet e etikës së kërkimit shkencor duke i vendosur ato në qendër të statuteve, kodit të etikës dhe rregulloreve të tyre.



- Pesha e votës së studentëve duhet të lidhet me peshën vendimmarrëse të tyre brenda institucionit, si aktorë kryesorë të marrjes së shërbimit. Ligji 80/2015 duhet të ndryshojë duke parashikuar një peshë më ndikuese në zgjedhjen e drejtuesve dhe organeve drejtuese.



- Vlerësimi i pedagogëve nga ana e studentëve duhet të jetë një praktikë reale dhe transparente në universitetet publike. Mungesa e informimit të studentëve dhe publikut e bën jo shumë të vlefshëm këtë proces.

# Aneks 1

## PYETËSOR PËR EKSPERTËT

**Datë:** \_\_\_\_\_ **Ekspert/e** (\_\_\_\_\_)

### Seksioni 1: Informacione të përgjithshme

#### Ekspert i/e angazhuar në

IAL publik     IAL jo publik     OJF     Ekspert/e i/e lirë     Tjetër(specifiko)

Gjinia             Femër     Mashkull

Mosha             20-30     30-40     40-50     50-60     60-70     70-...

Grada Shkencore / Titulli

- Docent     Doktor i Shkencave     Prof.Asoc.     Prof.Dr. (lëreni pa plotësuar nëse nuk keni këtë status)
- Akademik/I/e Asociuar/Emeritus (lëreni pa plotësuar nëse nuk keni këtë status)

### Seksioni 2: Pyetje të lidhura me çështjet e e identifikuar

Çështja	Ekspertë
Aksesi i studentëve në arsimin e lartë Pranimet në Universitete – Kriteret, procesi dhe roli i universitetit. (Problemi i mesatares për degët e mesuesisë, konkurset, tkurrja etj.)	Pyetja 1: A ka qartësi lidhur me parashikimet ligjore të aksesit të studentëve në arsimin e lartë? Janë rregulla mjafueshëm të qarta? Ndani qëndrim të njëjtë lidhur me to? Nëse jo, arsyetoni pse. Pyetja 2: Gjykoni që duhet të ketë një nivel hyrës të mesatares? Gjykoni që kjo çështje duhet të jetë e rregulluar në ligj/akt nënligjor? A është kjo në përputhje me autonominë e IALve? Nëse gjykoni që kjo çështje është e nevojshme të rregullohet në nivel ligji/akti nënligjor, paraqisni argumentet tuaj. Nëse jo, përsëri argumentoni. Nëse gjykoni që kjo çështje nuk duhet rregulluar në nivel politike, si do të garantohet cilësia në hyrje në IAL?
Shërbimet studentore	Pyetja 1: A ndikojnë shërbimet studentore në zvogëlimin e shkallës së braktisjes së universitetit? Pyetja 2: A ndikojnë shërbimet studentore në rritjen e diversitetit të përvojave të studentëve? Pyetja 3: Cilat janë shërbimet studentore që mungojnë aktualisht dhe që do të ndikonin në rritjen e klimës universitare?

	<p>Pyetja 4: Cilat janë shërbimet studentore që ofrohen aktualisht dhe që ndikojnë në ritjen e klimës universitare?</p>
<p>Liria akademike në Universitet në raport me zhvillimin e programeve të studimit, kërkimin shkencor, promovimin akademik.</p>	<p>Pyetja 3: A ka sjellë ligji i 2015 IAL hapësirë më të madhe lidhur me lirinë akademike? Ku reflektohet kjo? A ka, si rezultat i miratimit të ligjit, mundësi të shtuara të realizimit të programeve të përmirësuara të mësimin? A ka mekanizma të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies të reja apo të përmirësura si rezultat i ligjit të ri?</p> <p>Pyetja 4: Si mendoni ndihmon platforma RASH në zhvillimin e programeve të mësimdhënies?</p> <p>Pyetja 5: A janë shuar mundësitë e promovimit akademik për pedagogët, si pasojë e ligjit të 2015?</p> <p>Pyetja 6: A ka mundësi të shtuara financiare për realizimin e kërkimit shkencor? Sa përfitojnë pedagogët nga fonde të tilla?</p> <p>Pyetja 7: Sa kanë qenë fondet në dispozicion dhe a janë ato të mjaftueshme?</p> <p>Pyetja 8: A ka raporte transparence mbi këtë?</p> <p>Pyetja 9: Si e vlerësoni autonominë akademike në lidhje me ndryshimin në përmbajtjen e kurrikulës? Deri në çmasë mendoni se institucionet e arsimit të lartë duhet ta gëzojnë këtë liri (në një kohë që sot është deri në 20%)?</p>
<p>Administrimi financiar i Universitetit, nevojat akademike dhe studentore? Bordet?</p>	<p>Pyetja 1: A solli ligji i ri risi positive në lidhje me krijimin dhe funksionimin e këtij organi?</p> <p>Pyetja 2: A ka përfaqësim proporcional të njësive /fakulteteve në këto organe?</p> <p>Pyetja 3: A ka pjesëmarrje dhe transparencë të buxhetit, hartimit dhe shpenzimeve në IAL? A parshikon ligji i ri kërkesa lidhur me këtë?</p> <p>Pyetja 4: A përfshihen studentët në këtë proces? Garanton ligji i ri standarde të reja lidhur me këtë çështje?</p> <p>Pyetja 5: A janë rregullat e ndërlidhjes së shpenzimeve dhe procesit të funksionimit të IAL harmonike? A solli ligji i ri rregulla të përmirësuara në këtë drejtim?</p> <p>Pyetja 6: A është rritur autonomia financiare përmes diversifikimit të mënyrave të financimit të IAL-ve?</p> <p>Pyetja 7: A është rritur autonomia në administrimin e të ardhurave?</p> <p>Pyetja 8: Nese jeni në dijeni, përmes kujt organi/ autoriteti drejtues apo një aktori tjetër realizohet transparenca në lidhje me këtë proces?</p>

	Pyetja 9: Çfarë rekomandoni në lidhje me informimin apo pjesëmarrjen e personelit në lidhje me këtë proces.
Integriteti Akademik, Etika dhe kërkimi shkencor (rregullim ligjor nëpërmjet ekspertizës i procesit të identifikimit të plagjiaturës)	Pyetja 1: A janë çështjet e etikës së kërkimit shkencor të rregulluara në nivelin e duhur në ligj apo akte nënligjore? Pyetja 2: Çfarë masash janë marrë për zbatimin e kërkesave ligjore për këtë çështje? A janë të mjaftueshme? Pyetja 3: A ka ndihmuar ligji i ri në rritjen e vendimeve dhe marrjen e masave për shkelje të etikës kërkimore-shkencore? Si? Pyetja 4: Sistemi i identifikimit të plagjiaturës a funksionon në IAL? Si ka ndikuar ligji i ri në këtë proces?
Sistemi i vlerësimit të dyanshëm pedagog – student dhe anasjellas.	Pyetja 1: A është rishikuar ky system pas miratimit të ligjit të ri? Ç'risi solli ligji i ri në këtë drejtim?
Pesha e votës së studentëve në zgjedhjet akademike	Pyetja 1: A gjykoni që parashikimi ligjor lidhur me peshën e votës së studentëve në zgjedhje është proporcionalisht i drejtë? Cili është argumenti juaj për qëndrimin që mbani? Pyetja 2: Cilat do ishin sugjerimet tuaja lidhur me këtë çështje? Pyetja 2: A ka nevojë rishikimi i ligjit të 2015 në lidhje me këtë çështje? Pyetja 3: A mundëson procesi i zgjedhjeve meritokraci në zgjedhjen e organeve drejtuese? A mundëson ligji po aktet nënligjore një proces të rregullt dhe të pa ndikuar? A janë drejtuesit llogaridhënës? Ç'mekanizma përdorin për këtë?
Akreditimi i programeve të studimit në Universitete	Pyetja 1: A gjykoni që parashikimi ligjor lidhur me akreditimin përbën risi krahasuar me ligjin e mëparshëm? Identifikoni Pyetja 2: A ka ndërgjegjësim në strukturat e IAL lidhur me procesin e akreditimit? Pyetja 3: Identifikoni disa vështirësi që lidhen me këtë proces, dhe identifikoni nëse vijnë si rezultat i ligjit, akteve nënligjore, apo zbatimit të tyre.
Ligji 80/2015. Përmirësim apo rrezim në thelb?	Pyetja 1: Ç'mendoni për ligjin e IAL 2015? Pyetja 2: A ishte i nevojshëm? I domosdoshëm? Pyetja 3: Cfarë është ndërmarrë nga ju si hapa për zbatimin e ligjit?



	<p>Pyetja 4: A mendoni se ligji 80/2015 ka sjellë përmirësime të jetës universitare?</p> <p>Pyetja 5: Cilat janë problemet kryesore dhe sfidat e IAL në kuadër të zbatimit të ligjit?</p> <p>Pyetja 6: Cilat janë avantazhet kryesore? Cilat janë problemet? A ndikojnë ato në pengimin e zbatimit të ligjit?</p> <p>Pyetja 7: A është ligji që sjell këtë avantazhe/probleme?</p>
--	--

## Aneks 2

### Bisedë në grup me pedagogë / PYETJET PËR PEDAGOGË

Datë: \_\_\_\_\_

Pedagogët e ftuar/pjesëmarrës

Emër, mbiemër	IAL	Kontakt

#### Seksioni 1: Informacione të përgjithshme

**Pedagogë të angazhuar në**

Gjinia:  Femër  Mashkull

Moshë:  20-30  30-40  40-50  50-60  60-70  70-...

Grada Shkencore / Titulli:

Docent  Doctor i Shkencave  Prof.Asoc.  Prof.Dr. (lëreni pa plotësuar nëse nuk keni këtë status)

– Akademik/I/e Asociuar/Emeritus (lëreni pa plotësuar nëse nuk keni këtë status)

#### Seksioni 2: Pyetje për bisedën në grup me pedagogë lidhur me çështjet e identifikuar

Çështja	Pyetja
Akresi i studentëve në arsimin e lartë Pranimet në Universitete – Kriteret, procesi dhe roli i universitetit. (Problemi i mesatares për degët e mësuesisë, konkurset, turrja etj.)	Si e vlerësoni ligjin 80/2015 lidhur me aksesin e studentëve në arsimin e lartë? A janë rregullat mjaftueshëm të qarta? Si gjykoni lidhur me mesataren? Si gjykoni lidhur me sistemin pranues? A ka ndihmuar shpërndarje të drejtë të studentëve? A janë aktet nligjore të qarta e plota?
Shërbimet studentore universitare	A ofrojnë universitetet publike më shumë shërbime studentore se ato të ofruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit të arsimit të lartë të 2015-ës? Nëse po, cilat janë këto shërbime
.Liria akademike në Universitet në raport me zhvillimin e	A ka sjellë ligji 80/2015 hapësirë më të madhe lidhur me lirinë akademike: A gëzoni lirinë e nevojshme akademike?

<p>programeve të studimit, kërkimin shkencor, promovimin akademik.</p>	<p>Jeni të mbështetur në gjetjen e mjeteve të duhura për realizimin e programeve të përmirësuara të mësimi?  A ka dhe a përdoren mekanizma të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies të reja apo të përmirësura si rezultat i ligjit të ri?  A jeni përdorues të RASH: Si mendoni ndihmon kjo platformë zhvillimin e programeve të mësimdhënies?  A jeni mbështetur ju apo kolegë tuaj për promovimin akademik? Idenifikoni problematikat e ligjit dhe zbatimit të ligjit lidhur me këtë.  A janë ngritur organet e nevojshme për këtë në IALnë tuaj? Sa vendimmarrje të tilla janë dhënë pas miratimit të ligjit 2015?  A ka mundësi të shtuara financiare për realizimin e kërkimit shkencor? Sa kanë qenë fondet në dispozicion dhe a jeni njohur me mundësinë e përdorimit të tyre? A jeni njohur në kohë me këtë mundësi? Sa përfitoni si pedagog nga fonde të tilla?  A ka në IAL tuaj, Fakultetin tuaj burime të shtuara financiare për realizimin e kërkimit shkencor? Sa kanë qenë fondet në dispozicion dhe a jeni njohur me mundësinë e përdorimit të tyre? A jeni njohur në kohë me këtë mundësi? Sa përfitojnë pedagogët nga fonde të tilla? A ka raporte transparence mbi këtë?  A ka në IAL tuaj, Fakultetin tuaj struktura të posacme që ndihmojnë në identifikimin dhe aplikimin për fonde të kërkimit shkencor? A ju ndihmojnë ato për të identifikuar mjetet e kërkimit shkencor? A ka një përfshirje të barabartë në këto fonde?  A duhet që format e reja të mësimdhënies të shikohen si një alternativë e realizimit të procesit akademik, në kuadër të autonomisë akademike?</p>
<p>Administrimi financiar i Universitetit, nevojat akademike dhe studentore? Bordet?</p>	<p>A solli ligji i ri risi pozitive në lidhje me krijimin eëdhe funksionimin e këtij organi?  A janë të ngritura Bordet e Administrimit në IALtë?  A pati një process transparent për këtë?  A ka përfaqësim proporcional të njësive /fakulteteve të këto organe?  A ka pjesëmarrje dhe transparencë të buxhetit, hartimit dhe shpenzimeve në IAL? A parshikon ligji i ri kërkesa lidhur me këtë?  A janë rregullat e ndërlihdjes së shpenzimeve dhe procesit të funksionimit të IAL harmonike? A solli ligji i ri rregulla të përmirësuara në këtë drejtim?</p>

<p>Integriteti Akademik, Etika dhe kërkimi shkencor (rregullim ligjor nëpërmjet ekspertizës i procesit të identifikimit të plagjiaturës)</p>	<p>A janë çështjet e etikës së kërkimit shkencor të rregulluara në nivelin e duhur në ligj apo akte nënligjore?  Ç' masa janë marrë për zbatimin e kërkesave ligjore për këtë çështje? A janë të mjaftueshme?  A keni pasur raste të shkeljes së rregullave të etikës dhe nëse po, a janë hasur pengesa në adresimin e tyre?  A ka ndihmuar ligji i ri në ritjen e vendimeve dhe marrjen e masave për shkelje të etikës kërkimore-shkencore? Si?  Sistemi i identifikimit të plagjiaturës a është miratuar në IAL tuaj? A ju ndihmon në realizimin e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor?</p>
<p>Sistemi i vlerësimit të dyanshëm pedagog – student dhe anasjellas.</p>	<p>A përdoret në nivel IAL një sistem i fillë? A është rishikuar ky system pas miratimit të ligjit të ri? Ç' risi solli ligji i ri në këtë drejtim?  A janë realizuar të tilla vlerësime në IAL tuaj dhe a ka transparencë në IAL për këtë vlerësim?  A ka një politikë të privatësisë IAL për këtë?</p>
<p>Pesha e votës së studentëve në zgjedhjet akademike</p>	<p>A gjykoni që parashikimi ligjor lidhur me peshën e votës së studentëve në zgjedhje është proporcionalisht i drejtë?  Cili është argumenti juaj për qëndrimin që mbani?  A mundëson procesi i zgjedhjeve meritokraci në zgjedhjen e organeve drejtuese? A jeni ndjerë të lirë në procesin e zgjedhjeve dhe a keni parë të reflektuara në ligjin e ri problematikat e proceseve të mëparshme zgjedhore?  A janë drejtuesit e njësisë suaj llogaridhënës?  Ç' mekanizma përdorin për këtë konkretisht?</p>
<p>Akreditimi i programeve të studimit në Universitete</p>	<p>A gjykoni që parashikimi ligjor lidhur me akreditimin përbën risi krahasuar me ligjin e mëparshëm?  A ka ndërgjegjësim në strukturat e IAL lidhur me procesin e akreditimit?  Identifikoni disa vështirësi që lidhen me këtë proces për IAL tuaj, dhe identifikoni nëse vijnë si rezultat i ligjit apo akteve nënligjore, apo zbatimit të tyre.</p>
<p>Ligji 80/2015</p>	<p>Ç' mendoni për ligjin e IAL 2015: A ishte i nevojshëm? I domosdoshëm? Ka nevojë për ndryshime? Nëse po, identifikoni konkretisht.</p>



## Aneks 3

### Bisedë në grup me studentë / PYETJET PËR STUDENTË

Datë: \_\_\_\_\_ Studentët e ftuar/pjesëmarrës

Emër, mbiemër	IAL / Organizata	Kontakt

#### Seksioni 1: Informacione të përgjithshme

Gjinia:  Femër  Mashkull

Mosha:  20-30  30-40  40-50  50-60  60-70  70-...

#### Seksioni 2: Pyetje për bisedën në grup me studentë lidhur me çështjet e identifikuar

Çështja	Pyetja
Akresi i studentëve në arsimin e lartë Pranimet në Universitete – Kriteret, procesi dhe roli i universitetit. (Problemi i mesatares për degët e mësuesisë, konkurset, tkurrja etj.)	Si e vlerësoni ligjin e ri për IAL lidhur me aksesin tuaj në IAL? A janë rregullat mjafueshëm të qarta Si gjykoni lidhur me mesataren? Si gjykoni lidhur me sistemin pranues? A ka ndihmuar në shpërndarje të drejtë të studentëve? A janë aktet nënligjore të qarta e të plota?
.Liria akademike në Universitet në raport me zhvillimin e programeve të studimit, kërkimin shkencor, promovimin akademik.	A perceptoni që pedagogët kanë liri akademike? Si e përdorin atë? A ka sjellë ligji i 2015 I IAL hapësirë më të madhe lidhur me lirinë akademike? A keni në dispozicion mjetet e nevojshme për realizimin e programeve të mësimin? A ka dhe a përdoren mekanizma të kontrollit të cilësisë së mësimdhënies të reja apo të përmirësura si rezultat I ligjit të ri? A ka në IAL tuaj, Fakultetin tuaj, mjete të shtuara financiare për realizimin e kërkimit shkencor? Sa përfshihen ju në këto kërkime shkencore? Nëse po, a ka transparencë për përfshirjen në to? A mendoni që forma e mësimdhënies online është një formë e përshtatshme alternative e realizimit të procesit akademik në kuadër të autonomisë akademike?
Administrimi financiar i Universitetit, nevojat	A sollli ligji i ri risi pozitive në lidhje me krijimin eëdhe funksionimin e këtij organi?

akademike dhe studentore? Bordet?	A janë të ngritura Bordet e Administrimit në IALtë? A i njihni ju si studentë përfaqësuesit tuaj në to? A ka qenë procesi i zgjedhjes i drejtë? Identifikoni problemet nëse jo/ A përfitojnë studentët nga buxheti IAL?
Integriteti Akademik, Etika dhe kërkimi shkencor (rregullim ligjor nëpërmjet ekspertizës i procesit të identifikimit të plagjiaturës)	A janë çështjet e etikës së kërkimit shkencor të rregulluara në nivelin e duhur në ligj apo akte nënligjore? Ç' masa janë marrë për zbatimin e kërkesave ligjore për këtë çështje? A janë të mjaftueshme? A keni pasur raste të shkeljes së rregullave të etikës dhe nëse po, si i keni adresuar ju si studentë? A ka ndihmuar ligji i ri në rritjen e vendimeve dhe marrjen e masave për shkelje të etikës kërkimore-shkencore? Si? A ka sistem identifikimi të plagjiaturës në IAL tuaj? A ju ndihmon në realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor shkencor?
Sistemi i vlerësimit të dyanshëm pedagog – student dhe anasjellas.	A përdoren të tilla vlerësime në IAL? Si realizohen sistemet e vlerësimit? Keni sugjerime lidhur me to? A janë realizuar të tilla vlerësime në IAL tuaj dhe a ka transparencë në IAL për këtë vlerësim? Sa herë jeni përfshirë ju në të tilla vlerësime? A ka një politikë të privatësisë IAL për këtë?
Shërbimet studentore universitare	A ofrojnë universitetet publike më shumë shërbime studentore se ato të ofruar përpara hyrjes në fuqi të ligjit të arsimit të lartë të 2015-ës? Nëse po, cilat janë këto shërbime
Pesha e votës së studentëve në zgjedhjet akademike	A gjykoni që parashikimi ligjor lidhur me peshën e votës së studentëve në zgjedhje është proporcionalisht i drejtë? Cili është argumenti juaj për qëndrimin që mbani? A jeni ndjerë të lirë në procesin e zgjedhjeve dhe a keni parë të reflektuara në ligjin e ri problematikat e proceseve të mëparshme zgjedhore? A janë drejtuesit e njësisë suaj llogaridhënës? Ç'mekanizma përdorin për këtë konkretisht?
Akreditimi i programeve të studimit në Universitete	Si përshiheni ju si studentë në akreditimin e IAL? Sa njoftoheni për këtë proces dhe sa jeni trajnuar lidhur me realizimin e tij? Identifikoni disa vështirësi që lidhen me këtë proces për IAL tuaj, dhe identifikoni nëse vijnë si rezultat i ligjit, akteve nënligjore, apo zbatimit të tyre.
Ligji 80/2015	Ç'mendoni për ligjin 80/2015: A ishte i nevojshëm? I domosdoshëm? Ka nevojë për ndryshime? Nëse po, identifikoni konkretisht.

